

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit F. B., nga Komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson S. N., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria për Komunitete dhe Kthim, Prishtinë e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, Divizioni për Përfaqësim Gjyqësor, i përfaqësuar nga Naime Abazi, sipas autorizimit, për kompensim të pagave, përkitazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1580/2013 datë 23.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 2.11.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1580/2013 datë 23.11.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1580/2013 datë 23.11.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Prishtinë, C.nr.298/2007 datë 29.1.2013, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura Ministria për Komunitete dhe Kthim, Prishtinë, që paditësit t'ia paguajë pagat e parealizuara për periudhën prej 01.01.2006 e deri më 31.5.2007, për çdo muaj nga 238.65 €, shumën totale për pagesë prej 4057.05 €, me kamatë prej datës 20.7.2007 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 239.20 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit

të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës , me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës , në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion , dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me vendimin nr. ..., datë ..., të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës – Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, është aprovuar ankesa e paditësit dhe është anuluar vendimi i Komisionit për Ankesa të organit punëdhënës-Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve i datës 13.3.2006, nr. ..., Është urdhëruar e paditura që në afat prej 15 ditësh ta kthejë paditësin në punë – shef i personelit dhe t'i realizojë të gjitha të drejtat nga kontrata e punës nr. ...

Paditësi me padi ka kërkuar që e paditura t'ia paguajë pagat e perealizuara për periudhën prej 01.1.2006 kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri më 31.5.2007, koha e përfundimit të kontratës.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, nga fakti se vendimi i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është vërtetuar se është i kundërligjshëm, ndërsa si pasojë e saj paditësi ka pësuar dëm material për periudhën kontestuese, dhe duke zbatuar nenin 154, 155 dhe 262 të LMD-së, ka obliguar të paditurën që paditësit t'ia paguajë pagat e perealizuara, më afër përshkruar si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës , dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të saj.

Në një gjendje të tillë faktike , Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët , lidhur me aprovimin e kërkesëpadiës së paditësit,

pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore , e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër gjykata e revizionit vlerëson se aktgjykimet e lartcekura nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika (e) LPK. Gjykata e revizionit vlerëson se ky pretendim ishte objekt shqyrtimi edhe para gjykatës së shkallës së dytë sipas ankesës , e cila në aktgjykimin e saj me të drejt ka vlerësuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përfshirë me shkeljen e nenit të cekur , ngase nuk ka kaluar afati në kuptim të nenit 376 par.1 të LMD –ës . Lidhur me këtë pretendim gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të mjaftueshme të cilat i mbështet edhe kjo Gjykatë e revizionit , pa pasur nevojë që të njëjtat të përsëriten edhe njëherë.

Pretendimet e cekura në revizion se padia është paraqitur pas skadimi të afatit dhe gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje kur nuk ka vepruar konform nenit 391 pika (f) të LPK –ës , Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase paditësit dëmi i është shkaktuar në vitin 2006 ndërsa padinë në gjykatë e ka paraqitur në vitin 2007, ndërsa nuk ka kaluar afati prej 3 vjetëve i paraparë me dispozitën e nenit 376 par.1 të LMD –ës, siç me të drejt ka vlerësuar dhe arsyetuar në aktgjykimin e saj gjykata e shkallës së dytë, andaj këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pa bazuara.

Pretendimin e të paditurës të cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët kanë bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore kur kanë vazhduar procedurën pasi që paditësi në seancën kryesore më datë 11.12.2012, ka heqë dorë nga kërkesa e tij për kthimin në punë, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar , ngase gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejt kanë vlerësuar se paditësi ka të drejt të heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë dhe procedura të vazhdoi në bazë të kërkesës për pagimin e pagave të papaguara.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimet e cekura në revizion: se paditësi nuk është i vetmi person i larguar nga puna për shkak të një teprice mbi kufijtë buxhetorë; se nuk është marrë për bazë Memorandumi i datës 26.8.2005 me të cilin është detyruar e paditura të bëjë

reduktimin e numrit të punëtorëve dhe faktin se shkak i largimit nga puna ka qenë duplikimi i pozitave të punës të e paditura, por të njëjtat nuk patën ndikim që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe, ngase objekt i shqyrtimit para gjykatës ka qenë kërkesëpapia e paditësit për pagat e papaguara për periudhën kontestuese, ndërsa është vërtetuar se vendimi i të paditurës për ndërprerjen e kontratës së punës në kohë të caktuar ka qenë i kundërligjshëm.

Në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret se ku qëndron zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, andaj edhe pretendimet në këtë drejtim u vlerësuan si të pabazuara.

Për arsyet e paraqitura më lart, dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.268/2016 datë 2.11.2016

Kryetarja e kolegjit,
Emine Kaçiku